Ne bazet te tregueseve te mesiperme Bashkia Tepelene konsiderohet ne shtate normale te gjendjes financiare

Situata Normale e gjendjes
financiare

❖ **Cilat jane disa nga problematikat kryesore qe jane vrejtur gjate ketij vitit ushtrimor per te permiresuar ne te ardhmen .**

- Nje ndryshim rrenjesor ne punen e mbledhjes se te ardhurave si nga Sektori e Tatim Taksave si dhe agjentet e tjere tatimor ku nje rol te rendesishem ze Drejtoria e Bujqesise, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimi e Kontrollit mbi Territorin e Policia Bashkiake
- Planifikim I sakt dhe zgjerimi I bazes se tatim paguesve si ne qytet dhe ne njesite administrative.
- Planifikim I sakt e I argumentuar I kerkesave per shpenzime nga njesite shpenzuese .
- Pune me e kujdesshme e me pergjegjesi me te larte te Drejtorise Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar ne dokumentimin ne kohe dhe kryerjen e pagesave vetem kur ato te jene te shoqeruara me dokumentacionin e plot justifikues dhe te jene te programuara ne buxhetet afatmesme e vjetore.
- Permiresimi ne vazhdimesi I rregullores se brendeshme te institucionit ku te percaktohen qarte detyrat e gjithesecilit dhe mbi kete baze te dale dhe pergjegjesia.
- Auditimi I performances dhe funksionimi I sistemeve te kontrollit te brendshem mbete nje nga drejtimet kryesore.
- Zbatimi I Rekomandimeve te KLSH eshte nje prioritet kryesor

N/Zbatues

Spiro Kora



PASQYRAT FINANCIARE VITI 2024

(Komente e Analiza)

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2024 janë hartuar dhe depozituar më datën 11.02.2025 në Degën e Thesarit, me nr. prot 54

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare

Në fund të periudhës ushtrimore 2024 janë plotësuar 7 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme",

Formati 1 – Pasqyra e Pozicionit Financiar

Formati 2 – Pasqyra e Performancës Financiare

Formati 3 – Pasqyra e Flukseve Monetare (*Cash Floë*)

Formati 4 – Pasqyra e ndryshimeve në Aktivët Neto/ Fondet Neto

Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese

Formati 6 – Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit

Formati 7/a – Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike

Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto

Formati 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.

Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivët ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrollë të llogarive dhe dokumenteve

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët 2,973,999,699 lekë

	Viti 2024
AKTIVET	2,973,999,699
PASIVET(DETYRIMET)	2,973,999,699
AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	0

Burimi: Bashkia

1.1 Aktivët afatshkurtra

Aktivët afatshkurta më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën 258,940,646 leke

dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 24,870,072 leke

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **30,723,408 leke**
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **166,318,952 leke** dhe “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **37,028,214 leke**

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti i 2023	Diferenca 2024-2023
531	Mjete monetare ne arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	24,870,072	19,652,145	5,217,927
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provizione zhvlerësimi	-	-	-
	TOTALI	24,870,072	19,652,145	5,217,927

Burimi: Bashkia

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën **24,870,072 lekë**, përbëhet nga:

- Llog 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën 20,030,878 lekë; dhe
- Llog 85 “Rezultati i veprimtrisë ushtrimore” në shumën 4,839,194 lekë;

Llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” është paraqitur saktë në bilanc.

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
31	Materiale	11,257,111	7,435,068	3,822,043
32	Objekte inventari Inventar i imët	19,466,267	18,169,768	1,296,499
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizione për zhvlerësim te inventarit(-)			
	Totali	30,723,408	25,604,836	5,118,572

Burimi: Bashkia

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë në 31.12.2024 paraqitet në vlerën **30,723,408 lekë** dhe përbëhet nga:

- Llogaria kontabël 31 “Materiale” për shumën 11,257,111 lekë;
- Llogaria kontabel 32 “Objekte inventari” për shumën 19.466,297 lekë;
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 5,118,572 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit” në shumën 5,118,572 lekë.
- Llogaria 312 “Materiale” ka vlerën 11,257,111 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	7,435,068
Hyrjet në magazinë gjatë vitit	73,362,591
Dalje nga magazina gjatë vitit	69,540,548
Gjendja në 31.12.2024	11,257,111

Burimi: Bashkia

- **Llogaria 327 "Objekte inventari"** ka vlerën 18,169,768 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	18,169,768
Hyrje gjatë vitit 2024	1,296,529
Dalje gjatë vitit 2024	0
Gjendja në 31.12.2024	19,466,267

Burimi: Bashkia

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhërin e Inventarizimit Nr. 178 datë 19.11.2024 për "Kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qendrueshme, inventarit të imet e materialeve" ku është përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

- **Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"** përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	1,254,774	1,254,774	0
431	Tatime e taksa	-	-	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	-	-	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	-	-	
435	Sigurime Shoqërore	-	-	
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	-	-	
44	Institucione të tjera publike	-	-	
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-	
468	Debitorë të ndryshëm	172,966,870	153,584,876	19,411,994
4342	Të tjera operacione me shtetin(debitor)	33,157,848	27,529,213	5,628,635
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	
49	Shuma të parashikuara për zhvleresim(-)	-41,090,540	-41,090,540	0
	Totali	166,318,952	141,278,323	25,040,629
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	-	-	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	37,028,214	33,874,193	3,154,021
	Totali	37,028,214	33,874,193	3,154,021

Burimi: Bashkia

- **Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"** në fund të vitit 2024 është në vlerën 172,996,870 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepricën e vitit 2023 dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite në shumën 19,404,794 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
----------------------	---------------

Gjendja në 01.01.2024	153,584,876
Shtesa gjatë vitit 2023 debitoret e taksave	26,093,368
Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	6,681,374
Gjendja në 31.12.2024	172,996,870

Burimi: Bashkia

Gjatë evidentimit të llogarive analitike janë evidentuar në llogaritë analitike për vitin 2024 debitorët për taksat dhe tarifatat vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë, janë evidentuar detyrimet për vitin 2024, detyrime të cilat paraqitet si më poshtë vijon:

Debitore Bashkia dhe NJA	Gjendja 31.12.2024	Gjendja 31.12.2023
Debitorë Gjopa IVMT	2,290,000	2,290,000
Debitorë KLSH	84,992,244	84,992,244
Debitorë Legalizim	2,051,979	2,097,557
Debitorë Biznesi (zyra e tatimeve)	24,069,618	22,226,565
Debitorë Ujesjellesi Agjent tatimor)	18,868,344	16,443,652
Debitorë Kontrata qeraje	1,501,688	816,212
Debitorë në pamundësi arkëtimi	24,718,646	24,718,646
Debitore takse tole bujqesore	11,604,351	0
Debitore Leje treg.karburanti	2,900,000	0
Totali	172,996,870	153,584,876

Burimi: Bashkia

Ky veprim është kryer në përputhje me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" ku citohet:

"Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga:

☐ Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm.

☐ Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm.

Të drejtat. Funksionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitorohen (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116).

Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve).

Funksionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmblendhur është si më poshtë:

a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat:

☐ Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit);

☐ Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve direkte);

☐ Kreditohet klasa 7 me analiza;

☐ Kreditohet 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje).

b) Arkëtohen të drejta të konstatuara:

☐ Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza;

☐ Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza.

c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:

- ☐ Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);
- ☐ Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;
- ☐ Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)”

Pra është vlerësuar Llogaria 468 “Debitorë të ndryshën” dhe Llogaria e 70 “ Të ardhurat nga taksat dhe tatime” duke e njohur të ardhurën për vitin 2023 në vlerën 153,584,876 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 172,996,870 lekë.

- **Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 33,157,848 lekë kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 33,157,848 lekë. Vlera prej 33,157,848 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	27,529,213
Shtesa gjatë vitit 2024(D)	31,158,148
Pakësime gjatë vitit 2024(K)	25,529,513
Gjendja në 31.12.2024	33,157,848

Burimi: Bashkia

Në mënyrë analitike paraqitet:

401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	0
42	Detyrime ndaj personelit	12,549,167
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	928,469
435	Sigurime Shoqerore	3,610,071
436	Sigurime Shendetsore	498,845
437,438,	Organizma te tjere shteterore	0
467	Kreditore te ndryshem	15,571,296
TOTALI		33,157,848

Burimi: Bashkia

- **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 37,028,214 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	33,874,193
Shtesa gjatë vitit 2024(D)	15,571,296
Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	12,417,275
Gjendja në 31.12.2023	37,028,214

Burimi: Bashkia

Vlera e kësaj llogarie në shumën **33,874,193 lekë**, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2024 ka patur një shtim të kësaj llogarie, pasi janë pa likujduar një pjesë e këtyrë detyrimeve.

Emërtimi i llogarive	Vlera
----------------------	-------

Shenzime gjyqësore	122,999
Shpenzime operative	33,196,986
Shpenzime për investime	3,708,229
Totali	37,028,214

Burimi: Bashkia

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2024, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: *"Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pafinancuara"*.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t'u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

1.2 Aktivet afatgjata

Mbi Aktivet Afatgjata jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale" në vlerën prej **1,275,000 lekë** përbëhen nga:

- Llog.202 "Studime dhe kërkime", në vlerën 1,275,000 lekë.

Sipas llogarisë analitike (Tabela anekse nr.1) vlera e kësaj llogarie është 1,275,000 lekë.

Diferenca 1,275,000 lekë është vlera e projektit të hartimit të planeve të mbarshtimit pyje kullota Njesia Kurvelesh

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	352,003
Shtesa gjatë vitit 2023(4D)	0
Pakësime gjatë vitit 2024(K)	352,003
Gjendja në 31.12.2024(D)	0

Burimi: Bashkia

Testi substancial

Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2024 rezulton në vlerën neto 1,275,000 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 "Studime dhe kërkime".

Analitikisht llogaria 202 "Studime dhe kërkime" paraqitet si më poshtë;

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vl.Kontabël	Amortizimi
I	Studim Projektim Rehabilitimi i fushes së mbetjeve Makosh	Copë	1	352,003	352,003
	Totali			352,003	352,003

Burimi: Bashkia

Mbi Aktive afatgjata financiare

Testet substanciale

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2023 me vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2024 në vlerën 0 lekë Ky seksion i bilancit kontabël për vitet 2023 dhe 2024 është paraqitur në vlerën 0 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie	0	0
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	0	0

Burimi: Bashkia

Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2024, paraqiten në shumën **2,703,252,090 leke** (me vlerë neto). Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën **2,336,319,642 lekë** (me vlerë neto), me një shtese te AAM -ve ne shumen 366,932,448 leke

Duke analizuar veprimet e shtesave dhe pakësimeve të AAM-ve sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës si në tabelën më poshtë,

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2023	SHTESA	PAKSIME	Gjendja me 31.12.2024
1	210	Toka,troje,Terene	300,575,585	2,272,032	0	302,847,617
2	211	Pyje,Kullota Plantacione	935,577,632	214,374,641	0	1,149,952,273
3	212	Ndertime e Konstruksione	438,534,581	61,704,000	0	500,238,581
4	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,081,471,367	153,289,272	0	1,234,760,639
5	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	12,608,947	1,018,800	0	13,627,747
6	215	Mjete transporti	22,605,689	545,100	0	23,150,789
7	218	Inventar ekonomik	38,490,466	2,909,628	0	41,400,094
		TOTALI	2,830,216,270	437,613,473	0	3,267,829,743

Burimi: Bashkia

- **Llogaria. 210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 302,847,617 leke me 31.12.2024, me një ndryshim në shtesë për 2,272,032 leke si rrjedhojë e regjistrimit të pasurive në ASHK .

- **Llogaria 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet më 31.12.2024 (me kosto historike) 1,149,952,273 lekë me një shtesë prej 214,374,641 lekë, ardhur nga rregjistrimi i pasurive në ASHK.
- **Llogaria e aktivitetit 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”** e cila pasqyron gjendjen e asetëve për llogari të Bashkisë, në fund të vitit 2022 rezulton me një kosto historike 500,238,581 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me një kosto historike 438,534,581 lekë, me një shtesë prej 61,704,000 lekë nga investimet e kryera dhe të përfunduara gjatë vitit 2024
- Lista me kosto historike e ndërtesave paraqitet në aneks;
- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë më datë 31.12.2023 në shumën 22,605,689 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2022 në vlerën 22,605,689 lekë. Që do të thotë se gjatë vitit 2023 nuk ka patur shtesa në Llogarinë 215 “Mjete transporti”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	22,605,689
Shtesa gjatë vitit 2023(D)	545,100
Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
Gjendja në 31.12.2024 (D)	23,150,789

Burimi: Bashkia

Tabela nr. 2- Llogaria analitike 215

Nr.	Emërtimi	Çmimi	Sipas të dhënave kontabël	
			Sasia	Vlera
I	Bashkia			X
1	Autoveturë	2,500,000	1	2,500,000
2	Mjet eskavator	3,132,000	1	3,132,000
3	Automjet tip Benz	1,830,000	1	1,830,000
4	Automjet Mitsubishi	1,998,200	1	1,998,200
5	Automjet Benz	1,998,000	1	1,998,200
6	Automjet Zjarrfikes	3,404,309	1	3,404,309
7	Automjet Zjarrfikes	959,880	1	959,880
8	Automjet Zjarrfikes	1,500,000	1	1,500,000
9	Makine teknologjike pastrimi	1,000,000	1	1,000,000
10	Makine teknologjike pastrimi	120,000	1	120,000
11	Mjet sherbimi Kamion	910,800	1	910,800
12	Mjet teknologjik pastrimi	4,797,600	1	4,797,600
	TOTALI			23,150,789

Burimi: Bashkia

Llogaria kontabël 218 "Inventar ekonomik" përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njesitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën 12,488,339 - lekë (vlere neto). Krahasuar me vitin 2023 llogaria 218 "Inventari ekonomik" është pakesuar për vlerën 212,457 lekë.

Levizjet Llog. 218 "Inventar ekonomik" për vitin 2024, vlera	
Çelje me 01.01.2024	12,700,796
Blerje me pagesë (D)	2,909,628
Blerje pa pagese (D)	0
Dalje nxjerrje jashtë përdorimit (K)	0
Amortizimi i vitit i akumuluar 2024	3,122,025
Gjendja me 31.12.2023 (D) Teprica Neto	12,488,399

Burimi: Bashkia

Llogaria 218 "Inventar ekonomik" amortizimin e akumuluar vjetor sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 3,122,025 lekë duke përdorur normë amortizimi 20%, në përputhje me UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet " Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara".

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 36. Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Mbi Investimet

- **Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2024, paraqiten në vlerën 179,159,103 lekë. Ky vlerësim financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jomateriale sipas tabelës mëposhtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 179,159,103 lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	1,500,000
2	Aktive Aftagjata materiale	201,924,272
3	Totali	203,424,272

Burimi: Bashkia

Për investimet e kryera gjatë vitit 2024, është debituar saktë llogarinë 231 dhe kredituar llogaritë e klasës 4. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 21 "Aktive afatgjata". Në mënyra analitike aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten në aneks.

1.3 PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

- **Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	0	4,973,015	-4,973,015
42	Detyrime ndaj personelit	12,549,167	12,398,209	151,258
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	928,469	1,736,624	-808,155
435	Sigurime Shoqerore	3,610,071	3,654,183	-44,112
436	Sigurime Shendetsore	498,845	515,396	-16,551
437,438,	Organizma te tjere shtetere	X	X	X
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	20,030,878	16,426,025	3,604,853
467	Kreditore te ndryshem	52,599,510	38,125,979	14,473,531
4341	Operacione me shtetin(detyrime	133,161,104	113,749,110	19,411,994
	Gjendja më fund të periudhës	223,378,044	191,578,541	31,799,503

Burimi: Bashkia

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"**, në fund të vitit 2024 është në vlerën 0 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia më 31.12.2024. Lëvizja e llogarise 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si më poshtë:

Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"	
Celje e vitit 2024	4,973,015
Shtesa (K)	295,574,788
Pakësime (D)	300,547,803
Gjendja në 31.12.2024 (K)	0

Burimi: Bashkia

- **Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit"**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë, paraqitet në vlerën 12,549,167 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për t'u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.
- **Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa"**, paraqitet në vlerën 928,469 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për detyrimet e muajit Dhjetor 2024 të cilat do të paguhet në muajin janar të vitit pasardhës.

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për muajin Dhjetor 2024 4,108,916 lekë.
- **Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 20,030,878 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 20,030,878 lekë.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2024	16,426,025
Shtesa	10,721,379
Pakësime	7,091,651
Gjendja në 31.12.2024	20,030,878

Burimi: Bashkia

Kjo shumë është e njëjtë me terpicën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520.

Një kopje të raporteve të llogarisë 466 dhe nënllogarive përkatëse jepet në aneks.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2024, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë.

Në mënyrë analitike, garancitë të cilat janë të trashëguara dhe janë të objekteve të përfunduar, për të cilën është mbajtur kjo garanci dhe është marrë në dorëzim, sipas vitit përkatës, paraqiten si në aneks.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**, paraqiten faturat e palikuiduara, vendime gjyqësore, investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2024 paraqiten në shumën 52,59,510 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2024 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2024	38,125,979
Shtesa gjatë vitit 2024 (d)	171,649,107
Pakësime gjatë vitit 2024(k)	157,175,576,
Gjendja në 31.12.2024	52,599,510

Burimi: Bashkia

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi vërejtur se nuk ka fatura të likujduara të pa rregjistruara në SIFQ për vitin 2024

- **Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”**, paraqitet me terpicë kreditore në vlerën **4,839,194** lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgoohen.

2. Pasqyra e Performancës financiare (F2)

-Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë më datë 31.12.2024 janë të kuadruara me Degën e Thesarit, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Dif
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	74,990,722	Akt rakordimi me Degën e Thesarit	74,990,722	0
Granti nga buxheti	335,853,119	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	335,853,119	0
Financim i pritshëm nga buxheti	33,157,848	Sipas llogarisë 7206	33,157,848	0
Totali të ardhurave	444,001,689	Totali të ardhura	444,001,689	0

Burimi: Bashkia

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2023	Detyrime të vitit 2024	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	174,664,396	14,295,719	13,477,636	173,846,313
601	25,046,107	4,169,421	4,108,916	24,985,602
602	112,581,954	7,064,373	15,571,296	121,088,877
604	8,631,884	0	0	8,631,884
606	115,731,691	0	0	115,731,691
63				-5,118,572
Totali	439,162,495	25,529,513	33,157,848	439,162,495

Burimi: Bashkia

-Diferenca në shumën – 5,118,572 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca e vlerës prej – 5,118,572 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

-Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 "shpenzimet" dhe klasës 7 "të ardhurat", janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore", konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	444,001,689	444,001,689	0
II	Shpenzime	439,162,495	439,162,495	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	4,839,194	4,839,194	0
IV	Rezultati i vitit ushtrimor	4,839,194	4,839,194	0

Burimi: Bashkia

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **4,839,194 lekë**, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

3. Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2024.

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	7,834,825	14,411,297
II	Veprimtaritë e investimeve	0	0
III	Transferta e të tjera	-2,616,898	-1,440,630
IV	Teperica në fillim të vitit ushtrimor	19,652,145	6,001,282
V	Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor	24,870,072	19,652,145

Burimi: Bashkia

-Nga kontrollët e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2024 e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën **24,870,072 lekë** dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Disponibilitet në Thesar" Llog 520" e cila paraqitet në shumën **24,870,072 lekë**.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare".

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **2,750,621,655 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

-Vlera prej 209,186,071 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

-Vlera prej – 59,226,065 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor dhe nxjerrjet jashtë përdorimit.

-Vlera prej 4,839,194 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85 dhe llog. 12 paraqitet në shumën 4,839,194 lekë.

-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën **2,750,621,655 lekë**. kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

Veprimet e mësipërme janë kryer sipas përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- Ligjin 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10 dhe ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin

- nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.
- Ligji nr. 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10” ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 “ Kreditorë për mjete në ruajtje”.
 - UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet “ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara”.
 - VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, ku cilësohet:
“1.Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njërive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtrin të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.
 - 2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen”.
 - VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”.

Hartuesi i Llogarise Vjetore

Spiro KORA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENË

Nr.....prot.

Tepelenë më, _____. 2025

MBI

ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE KONTROLLIT TE LARTE TE SHTETIT

Te nderuar keshilltare !

Ne baze te gjurmes auditimit te hartuar po ju raportojme mbi ecurin e zbatimit te rekomandimeve te KLSH te cilat jane pranuar nga institucioni I Bashkise .

KLSH me shkresen nr 620/6 date 31.07.2024 protokolluar me tonen nr 872/1 date 02.09.2024 ka rekomanduar disa masa per permiresimin e veprimtarise Bashkise dhe niveli I zbatimit te tyre eshte si me poshte ;

- Me shkresen nr 872/2 date 19.08.2024 I eshte ktthyer pergjigje KLSH ku kemi nenshkruar deklaraten qe konfirmon njohjen me raportin .
- Eshte hartuar plani I veprimit me nr 21/08 date 21.08.2024 “Per zbatimin e detyrave te rekomanduara Raporti I KLSH sipas vendimit nr 143 date 29.07.2024 me shkresen nr 620/+6 date 31.07.2024.
- Me shkresen nr 1690/3 prot date 17.09.2024 eshte informuar keshilli Bashkiak “Mbi raportin perfundimtar te Auditimit dhe tekomandimet “ te KLSH
- Urdheri nr 176 date 18.11.2024 I kryetrit te Bashkise “Per zbatim te detyrave te rekomanduara “
- Urdheri nr 177 date 18.11.2024 “Per kryerjen e vizites fiskale ne te gjithë subjketet persona fizik/juridic qe ushtrojne veprimtarine ne Bashkine Tepelene.
- Raporti nr 20/12 date 20.12.2024 per zbatimin e urdherit nr 177 date 18.11.2024
- Njoftimet e te gjithë subjketeve per detyrimet tatimore e kane ne zbatim te rekomandimeve.
- Urdherat e bllokimit te llogarive bankare per subjketet fizike e juridike.
- Me shkresen nr 112 prot date 22.01.2025 eshte njoftuar KLSH mbi zabatimin e rekomandimeve duke zbatuar kerkesat e ligjit brenda afatit 6 mujor.

B. MASA ORGANIZATIVE.

1.1Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, me atributet e Nenpunesit Autorizues, te marrë masa për hartimin dhe miratimin e nje strategjie te risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku bëhet indentifikimi,analiza dhe kontrolli i risqeve që mund te kenë impakt ne arritjen e objektivave te institucionit;Hartimin dhe zhvillimin e programeve te trajnimeve për

ngritjen profesionale të stafit; Vendorsjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësish.

Menjhere dhe ne vijimesi

Pjesersht e zbatuar (ne proces)

2.1 Rekomandimi: Njesia e Auditimit të Brendshëm, te marrë masa për kryerjen e auditimit për zbatimin të kekomandimeve për 6-mujorin paraardhës te lëna nga NJAB. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Ne vijimesi

Pjeserisht i zbatuar

3.1 Rekomandimi: Bashkia Tepelenë per vitin 2024 të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapamberura në vlerën 33,874,193 lekë sipas metodës FIFO dhe duke aplikuar një balancë mes kufizimit të shpenzimeve dhe shlyerjes së detyrimeve, përkatësisht 5,528,329 lekë të vendimeve gjyqësore, duke marrë keto masa: reduktimin e shpenzimeve, rritjen e te ardhurave vendore, mbledhjen dhe arketimin e depitoreve, kërkimin e çeljes së fondeve nga qendra sipas burimit financimit të investimeme të kryera.

Brenda vitit 2024

Pjeserisht e zbatuar , ne proces

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për të drejtuar në pustet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranura.

Deri me 31.03.2025

Zbatuar

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë të bëjë korrektime të duhura për llogaritjen e autorizimit të aktiveve afatgjata jo materiale dhe të kryejë sistemimet kontabël në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

Deri me 31.03.2025

Zbatuar

6.1 Rekomandimi: Bashkia Tepelenë te marrë masa për sigurimin e likuidimeve, në menyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*perjashtuar kufizimet e MFE*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura tëpa likujduara dhe krijimin e vështirësive në aftësinë paguese.

Menjhere dhe ne vijimesi

Ne proces zbatimi

7.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë te marrë masa për ngritjen e një grupi pune për indentifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar të cilat i janë transferuar

në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre të vijuar me aplikimet përkatëse për paisje me çertifikatë pronësie.

Menjëherë

Pjesërisht e zbatuar , ne proces

8.1 Rekomandimi: Bazuar ne nenet 15 dhe 16, te Ligjit nr.154/2014, date 27.11/.2024”Per Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit te Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes , Ju rikujtojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan te pazbatuara dhe te zbatuara pjesërisht, si dhe përjashtimin e atyre në proces zbatimi, si me poshtë:

Ne proces

A. Masa Organizative

2.1.Rekomandimi: Nga Njesia e Auditimit të Brendshëm te merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, shtetëritja dhe implimentimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike , ne mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse t’i jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë,të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

Ne porces

6.1.Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorin e Buqësisë, të marrin masa për të indentifikuar numurin e familjeve që kanë tokë buqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër me pas të shërbej si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjarëve, referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Tepelenë,

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatuar

9.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit B. SHPK she të marrë masa që ky subjekt të paiset menjëherë me autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Tepelenë për 5 vjet, që nga data e mbarimit ne vitin 2022.Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore te ndjekë rregullisht pagesat periodike dhe të prapambetura te autorizimeve për të gjithë subjektet:B.Shpk ne vlerën 100,000 lekë, O. Shpk në vlerën 380,000 lekë,dhe S.G Shpk në vlerën 800,000lekë me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afatit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatuar

21.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi .

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatuar

23.1.Rekomandimi: Nga IVMT të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren për të konstatuar ndërtimet informale dhe ato që nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara, duke marrë vendime për prishje dhe duke i ekzekutuar ato, në baze të legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Ne proces

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËRTATIM TAKSA VENDORE PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatim Taksave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet që janë legalizuar me vlerë 2,097,558 lekë.

Në vijimësi

Ne proces

2.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxerjen e njofimit të vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive **22,233,772 lekë** e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për 184 subjekte biznes I vogël në shumën 599,060 lekë:
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për 49 subjekte biznes Imadh në shumën 11,536,571 lekë.
- Detyrimet nga 6 institucione në shumën 769,648 lekë:
- Detyrimet nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në 3 raste në shumën 10,313,690 lekë.
- Detyrimet nga NJ.A qënder në shumën 9,328,493 lekë.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasurit e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar , Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në veç aktivitetet tregtar të tatim

paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo ditë të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d-Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të mërrren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkë rendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për mos kalimin e subjekteve debitoare me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f-Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërrmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e depitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Pjesërisht e zbatuar, në proces

3.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Tatim Taksave dhe arifave Vendore NJA, të marrë masa për krijimin e regjistrat të taksave dhe tarifave vendore për paksapaguesit e kategorisë “familjare” me të gjitha të dhënat e nevojshme, I cili të shërbej si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë, Bashkia Tepelenë, bazuar në kontratën dypalëshe me agentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 16,397,158 lekë në llogarinë përkatëse në degën e thesarit

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatuar

D. MASA PËR ELEMENIMIN E E FEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TRIFAT VENDORE, ME EFEKT TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Tepelenë Sektorit i Tatim Taksave në bashkpunim me Drejtorinë e Finances të marrin masa të kontabilizojnë detyrimin e krijuar nga Sha Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë, si dhe bazuar në kontratën dypalëshe me agentin tatimor UK Tepelenë sha, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 2,785,790 lekë në llogarinë përkatëse në degen e thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Pjesërisht e zbatuar, në proces

2.1.Rekomandimi: Bashkia Tepelenë Sektorit i Tatim Taksave të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Tepelenë me vlerën 3,750,000 lekë Gjithashtu Sektorit i Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryen pagesat e plota brenda afatit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Pjeserisht e zbatuar, ne proces

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Nepunes Zbatues

Spiro KORA

KRYETAR I BASHKISË

TËRMET / PEÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KRYETARI

Nr. 312/5 prot.

Tepelenë, më 21. 02 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. Arben Gumeni

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

I nderuar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:
“Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.87/25 ZK 3661 ndodhur në fshatin Turan, Bashkia Tepelenë”.

Me respekt,

KRYETARI
Tërmet PEÇI

Miratoi:

Gërdan Shetani : Drejtor i Zhvillimit Rural
SPIC Koll : Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit
Julinda Karteri : Drejtor, Drejtorisë Juridike
: Përgjegjës i Sektorit

Konceptoi:

: Specialist i Sektorit

Datë: 12.02.2025

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 1

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt-vendimin: 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr. 312/5. pot

Tepelenë më, ____ . ____ . 2025

P/V E N D I M

Nr ____ . Datë ____ . 02.2025

“Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.87/25 ZK 3661 ndodhur në fshatin Turan, Bashkia Tepelenë”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr.8743 date 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” të ndryshuar; Ligjit 8744 date 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësite të qeverisjes vendore” të ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara”; VKM 843 datë 6.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Qendër Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë”; VKM 433/2016 të ndryshuar; mbështetur në të dhënat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) statusi juridik i pasurive;

V E N D O S I:

1. Azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.87/25 ZK3661 fshati Turan, e llojit “arë” e cila është pronë e Bashkisë Tepelenë, dhe përdorimin e kësaj pasurie për rrugë për lidhjen e rrugës kryesore me parcelat bujqësore e kullotat publike e private, sipas planvendosjes bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Jurist

Julinda Kërteri

KRYETAR

Arben Gumani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL

Tepelenë më, 12.02.2025

RELACION

“Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasuritë nr.87/25 ZK 3661 ndodhur në fshatin Turan, Bashkia Tepelenë”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr.8743 date 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” të ndryshuar; Ligjit 8744 date 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitet e qeverisjes vendore” të ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara”; VKM 843 datë 6.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Qendër Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë”; VKM 433/2016 të ndryshuar; mbështetur në të dhënat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) statusi juridik i pasurive;

VENDOSI:

1. Azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.87/25 ZK3661 fshati Turan, e llojit “arë” e cila është pronë e Bashkisë Tepelenë, dhe përdorimin e kësaj pasurie për rrugë për lidhjen e rrugës kryesore me parcelat bujqësore e kullotat publike e private, sipas planvendosjes bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Bashkëlidhur janë planvendosja, inventari dhe fragment i hartës kadastrale dhe kopje e kartelës së pasurisë.

Grupi i Punës:

1. Maksim Shehu

2. Gëzim Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

1225/13
15 12 1

V E N D I M

Nr. 843, datë 6.12.2011

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS QENDËR TEPELENË, TË QARKUT
TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:


1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Qendër Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1111 (një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM



BUJAR NISHANI

400 - 402	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
403	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve social-kulturore e sportive.	Në pronësi
404	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
405 - 605	Troje të lira dhe hapsira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
606 - 617	Varreza publike	Në pronësi
675	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujsjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
744-775, 777-798, 800-815, 817-832, 834-864, 866-890, 904-925, 927-967, 969-1019, 1021-1034, 1036-1049.	Infrastrukturë (sheshe, rrugë, vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
1050-1051, 1054-1055, 1058-1059, 1063-1064, 1068-1069, 1073-1074, 1078, 1081-1082, 1086-1087, 1090-1091, 1095-1096, 1101-1102, 1105-1106.	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. (toka produktive)	Në përdorim DAMT e komunës së bashku me atë të qarkut Gjirokastrë ka vënë në dispozicion të AKKP-së nga kjo komunë sipërfaqen prej 40.94. Kjo sipërfaqe është dorëzuar në AKKP bashkë me dokumentacionin shoqërues.
1052-1053, 1056-1057, 1060-1062, 1065-1067, 1070-1072, 1075-1077, 1079-1080, 1083-1085, 1088-1089, 1092-1094, 1097-1100, 1103-1104, 1107-1108. 630, 632, 635, 640, 643, 647, 649, 651, 653, 657, 660, 663, 667, 669, 672, 674	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. (toka joproduktive dhe vetëm kanalet e treta)	Në pronësi (vetëm kanalet e treta)

MINISTRI

BUJAR NISHANI


NR.PROT.3413/1
DATE 15.12.2011

MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE
MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLIT TË QARKUT GJIROKASTËR
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË
PRONAVE
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA

Sekretar

Përgjithshëm



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
										hen në fazën e afishimit Kjo pronë vlen vetëm për zërin ledh.
1068	3661		Arë		Arë Fshati Turan Komuna Qendër Tepelenë	63 6000	Arë	M.B.U.M.K	D.R.B.U Gjirokastrë	
1069	3661		Pemtores		Pemtores Fshati Turan Komuna Qendër Tepelenë	17 4000	Pemtores	M.B.U.M.K	D.R.B.U Gjirokastrë	
1070	3661		Kënetë		Kënetë Fshati Turan Komuna Qendër Tepelenë	2 7000	Kënetë	M.B.U.M.K	D.R.B.U Gjirokastrë	
1071	3661		Ranishte		Ranishte Fshati Turan Komuna Qendër Tepelenë	12 2000	Ranishte	M.B.U.M.K	D.R.B.U Gjirokastrë	
1072	3661		Ledh		Ledh Fshati Turan Komuna Qendër Tepelenë	21 0000	Ledh	M.B.U.M.K	D.R.B.U Gjirokastrë	Në zërin Ledh janë përfshirë Rrugë nacion, rurale, fshati, kanale, të cilat duhet të nda-
										hen në fazën e afishimit Kjo pronë vlen vetëm për zërin ledh.
1073	2582		Arë		Arë Fshati Mamaj Komuna Qendër Tepelenë	40 3000	Arë	M.B.U.M.K	D.R.B.U Gjirokastrë	



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3661004144

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3661, Lloji i Pasurisë: ARE, Nr. i Pasurisë: 87/25, Sipërfaqja Totale 891 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-136-31-A, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia TEPELENE, Rruga TURAN, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti
Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. _____, Dt. 31/03/2016), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET SHTET SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT S12345670S, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i
Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr.
_____, Datë: 31/03/2016

Regjistruar: Nr. 00118, Datë: 31/03/2016

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi:

DREJTORI
Kleona Bahja

Trandafil
e

Digitally signed by:
Trandafil Duka
Date: 2024.11.21
09:16:19 +02'00'

Ahmedij
e

Digitally signed by:
Ahmedij Kleona
Date: 2024.11.21
02:26:00 +02'00'

Kleona
Bahja

Digitally signed by:
Kleona Bahja
Date: 2024.11.21
03:06:57 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tepelenë
Date: 2024/11/21 09:15:55 +02'00'
K49322529O2024112109154816ASHK



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 3661

KODI UNIK: 3661004144

NUMRI I PASURISË: 87/25

INDEKSI I HARTËS: K-34-136-31-A

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:500

DREJTORI
Kleona Bahja

Ahmedij
e

Digitally signed by:
Ahmedije Gjani
Date: 2024.11.21
02:25:40 +02'00'


Kleona
Bahja

Data e lëshimit 21/11/2024
Digitally signed by:
Kleona Bahja
Date: 2024.11.21
03:03:09 +02'00'

SHPJEGUES

PARCELA

NDËRTESA



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK
TEPELENE**

Nr 312 Prot

Tepelenë më 17.02.2025

P/V E N D I M

Nr. ____ Datë. ____ 2025

PËR

**DETAJIMIN E PLAN – BUXHETIT PER TE ARDHURAT E TRASHEGUARA
NGA VITI 2024 ,DHE DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN KESHILLIT
BASHKISE NR 72 DATE 27.11.2024 ‘PER MIRATIMIN E BUXHETIT TE
VITIT 2025**

Keshilli i Bashkise Tepelene ne mbledhjen e dates ____ 2025, pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkise per disa shtesa ne vendimin e KB nr 72 date 27.11.2024 ‘Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 « mbeshtetur ne:

- Ligjin 139/2015 –date 17.12.2015, “Per vetëqeverisjen vendore ”,
- Ligjin 57/2016, datë 02.06.2016 “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr 9936 date 26.06.2008 ‘ Per menaxhimin e sistemit e buxhetor ne Republiken e Shqiperise”; neni 44
- Ligji 68/2017 « Per financat e vetëqeverisjes vendore « neni 46
- V.K.B Nr 72, datë 27.11.2024 .’Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 “
- Vendimi i Keshillit Ministrave Nr 742 date 13.12.2017 ‘Per zbatimin e marrveshjes se bashkepunimit ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Greqise per kerkimin,Zhvarrimin,indetifikimin dhe varrimin e ushtareve greke te rene ne Shqiperi gjate luftes Greko -Italiene te viteve 1940-1941 dhe per ndertimin e vendeprehjes per ta brenda teritorit te Rerpublikes se Shqiperise.,ratifikuar me ligjin Nr 10256 date 25.3.2010

V E N D O S I:

1. Te ardhurat e trasheguara sipas pasqyrave financiare te vitit 2024 per vitin buxhetor 2025 ne shumen 4,839,194 leke do te detajohen ne plan -buxhet si si me poshte ;

Shtohet ;

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	01	01110	602	9999999	1,863,383
2	05	01110	602	9999999	2,975,811

Shtesat gjithesej ; 4,839,194 Leke

2. Ne buxhetin e miratuar per vitin 2025 behen keto ndryshime ;

Shtohen

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	01	03280	602	9999999	8,524,000
2	05	03280	602	9999999	5,476,000

Shtesat gjithesej 14,000,000 leke

Pakesohet

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	01	03280	609	9999999	8,524,000
	05	03280	609	9999999	5,476,000

Shuma gjithesej ; 14,000,000 leke

3. **Shtesa ne planin e buxhetit per vitin 2025** “ .Fondet qe do te trasferohen nga Qeveria Greke ne sistemin e thesarit per llogari te Bashkise Tepelene ne shumen **4,500,000 leke** do te perdoren : Per perbalimin e shpenzimeve korente te kryera si pagesa e punonjesve, shpenzimet e energjise elektrike e shpenzime te tjera sipas kodifikimit te mepeoshtem;

Shtohen

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	O5	O6260	600	9999999	1,000,000
2	O5	O6260	602	9999999	3,500,000

Shtesat gjithesej ; 4,500,000 Leke

4. Miratimin e shumes se bashkfinancimit te projekteve me objekt si me poshte;

- a. Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare "7 Marsi" ne masen 15 % te vleres se investimit ne shumen 22,050,000 leke
- b. Rikonstruksion i Diges se Ujembedhesit Turan ne masen 20 % te vleres se investimit 19,750,000 leke

Autorizohet kryetari i Bashkise qe ne mbeshtetje te ligjit Per menaxhimin e sistemit e buxhetor ne Republiken e Shqiperise"; neni 44, Ligji 68/2017 « Per financat e vetëqeverisjes vendore » neni 46 te beje ndryshimet e nevojshme brenda te njetit program ne objektet e investimeve.

5. Miratimin e dhenies se ndihmes se menjehereshme financiare per familjet ne ne pamudesi financiare te medha per rikonstruksion e banesave , raste semundjesh te renda si dhe deme te shkatuara nga fatekeqesi natyrore (zjarre) ne shumen **1,500,000_ leke** si pjese e fondit te miratuar "per transferta te tjera te individe " ne buxhetin e vitit 2025 sipas pasqyres bashkanjitur ketij vendimi.

Miratimin e kryerjes se rikonstruksion te cative me nje sip prej 450 m2 ne tre banesa kolektive 2 kateshe te cilat nuk jane pjese e projektit "rikonstruksion i banesave per familjet e pafavorizuara" aplikuar prane Ministrise Financave , ne shumen 2,250,000 leke si pjese e shpenzimeve per mirembajtjen te programuara per vitin 2025 duke zbatuar te gjitha procedurat ligjore.

6-Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Ligjore & Sherbimeve Organizative per zbatimin e ketij vendimi

7- Ky vendim hyne ne fuqi sipas percaktimeve te nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 "Per Veteqeverisjen vendore " te ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucionit i Prefektit te Qarkut Gjirokaster.

Drejtoria Juridike
Julinda KARTERI

Drejtoria e Finances
Spiro KORA

KRYETARI

Arben Gumeni

BASHKIA TEPELENE
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK & MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr 342 prot

Tepelen me 17.02. 2025

RELACION

Per

**DETAJIMIN E PLAN – BUXHETIT PER TE ARDHURAT E TRASHEGUARA NGA
VITI 2024 ,DHE DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN KESHILLIT BASHKISE NR 72
DATE 27.11.2024 ‘PER MIRATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2025**

KESHILLIT BASHKIAK

TEPELENE

Te nderuar Keshilltar !

Ne zbatim te ;

- Ligjin 139/2015 –date 17.12.2015, “Per vetëqeverisjen vendore ”,
- Ligjin 57/2016, datë 02.06.2016 “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr 9936 date 26.06.2008 ‘ Per menaxhimin e sistemit e buxhetor ne Republiken e Shqiperise”; neni 44
- Ligji 68/2017 « Per financat e vetëqeverisjes vendore « neni 46
- V.K.B Nr 77, datë 27.11.2024.’Per miratimin e buxhetit te vitit 2025“
- Vendimi i Keshillit Ministrave Nr 742 date 13.12.2017 ‘Per zbatimin e marrveshjes se bashkepunimit ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Greqise per kerkimin,Zhvarrimin,indetifikimin dhe varrimin e ushtareve greke te rene ne Shqiperi gjate luftes Greko -Italiiane te viteve 1940-1941 dhe per ndertimin e vendeprehjes per ta brenda teritorit te Rerpublikes se Shqiperise.,ratifikuar me ligjin Nr 10256 date 25.3.2010

Po ju parqesim per shqyrtim e miratimin disa ndryshime ne V.K.B Nr 77, datë 27.11.2024.’Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 te cilat nuk ndryshojne treguesit makro te keti buxheti por kane te bejne me disa shtesa ne zbatim te aktive ligjore dhe situatave financiare te krijuara gjate veprimtarise 2 mujore te vitit 2025

1. Mbas mbylljes se pasqyrave financiare te vitit 2024 kemi te trasheguar per vitin 2025 te ardhura **ne shumen 4,839,194 leke te cilat do te detajohen ne plan -buxhet si si me poshte ;**

Shtohet ;

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	01	01110	602	9999999	1,863,383
2	05	01110	602	9999999	2,975,811

Shtesat gjithesej ; 4,839,194 Leke

2. Ne buxhetin e miratuar per vitin 2025 kemi planifikuar ne programin buxhetor 'mbrojtja civile " Shumen prej 14,000,000 leke te cilat duhet ti bejme te perdoreshme per situatete cilat mund te na krijohen gjate viti , per kete po ju paqwsim per miartim detajimin e plan buxhetit si me poshte;

Ne buxhetin e miratuar per vitin 2025 behen keto ndryshime ;

Shtohen

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	01	03280	602	9999999	8,524,000
2	05	03280	602	9999999	5,476,000

Shtesat gjithesej 14,000,000 leke

Pakesohet

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	01	03280	609	9999999	8,524,000
	05	03280	609	9999999	5,476,000

Shuma gjithesej ; 14,000,000 leke

3. Bashkia ka aplikur ne disa thirrje per financim projektesh nga Ministrit e linjes dhe konkretisht te Ministria e Arsimit e Sporteve per rikonstrukcion e shkolles 9 vjecare 7 Marsi dhe te Agjensia Kombetare e Mbrojtjes Civile per objektin " rikonstrukcion I diges se ujembledhesit Turan." Por keto projekte qe te financohen kane kushtin qe bashkia duhet te jete bashkefinancuese perkatesish me 15 % dhe 20 % te vleres se preventivuar ,per te realizuar kete ju paraqesim ndryshimet e meposhte ne buxhet.

Shuma e bashkfinancimit te projekteve me objekt si me poshte;

- a. Rikonstrukcion i shkolles 9 vjecare "7 Marsi "ne masen 15 % te vleres se investimit ne shumen 22,050,000 leke
- b. Rikonstrukcion i Diges se Ujembledhesit Turan ne masen 20 % te vleres se investimit 19,750,000 leke

Nisur nga fakti qe nuk kemi te bejme me ndryshime ne programet buxhetore por Brenda te njetit program buxhetor si dhe ky bashkfinancimet do te shtrihet ne nje periudhe buxhetore afatmesme menojme qe te Autorizohet kryetari i Bashkise qe ne mbeshtetje te ligjit Per menaxhimin e sistemit e buxhetor ne Republiken e Shqiperise” ; neni 44, Ligji 68/2017 « Per financat e vetëqevrisjes vendore » neni 46 te beje ndryshimet e nevojshme brenda te njetit program.ne objektet e investimeve.

4. Ne zbatim te Vendimi i Keshillit Ministrave Nr 742 date 13.12.2017 ‘Per zbatimin e marrveshjes se bashkepunimit ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Greqise per kerkimin,Zhvarrimin,indetifikimin dhe varrimin e ushtareve greke te rene ne Shqiperi gjate luftes Greko -Italiane te viteve 1940-1941 dhe per ndertimin e vendeprehjes per ta brenda teritorit te Rerpublikes se Shqiperise.,ratifikuar me ligjin Nr 10256 date 25.3.2010 do te vazhdohet bashkepunimi me palen greke per kryerjen e sherbimeve dhe levrimin e fondeve si me poshte ;

Shtesa ne planin e buxhetit per vitin 2025 “.Fondet qe do te trasferohen nga Qeveria Greke ne sistemin e thesarit per llogari te Bashkise Tepelene ne shumen **4,500,000** leke do te perdoren : Per perbalimin e shpenzimeve korente te kryera si pagesa e punonjesve, shepnzimet e energjise elektrike e shpenzime te tjera sipas kodifikimit te mepeoshtem;

Shtohen

Nr	Kapitulli	Programi	Llog.ekon	Kodi Projektit	Shuma
1	O5	O6260	600	9999999	1,000,000
2	O5	O6260	602	9999999	3,500,000

Shtesat gjithesej ; 4,500,000 Leke

5. Mbeshtetja e familjve ne nevojte mbetet nje nga prioritetet veprimtarise se bashkise dhe per kete nisur nga kerkesat e shuma te ardhuar, nga rekomandimet e keshillit bashkiak me shkresen nr 1 date 6.02.2025 si dhe kerkesat nga Njesite administrative , brenda buxhetit te miratuar per vitin 2025 ,propozojme perdorimin e nje pjese te ketij fondi per familjet e individet ne nevojte ne nevojte sipas listes emrrore qe shoqeron kete relacion

Mbulimi i shpenzimeve te mesiperme do te behet nga Buxheti i Miratura per vitin 2025 ne llogarine ekonomike 606 “Te tjera transferta te individe “ne shumen **1,500,000 Leke**

Nga fondi I planifikuar me siper do te likujdohen dhe nje pjese e detyrimeve per sigurimet shoqerore per punonjesit qe dalin ne pension dhe ne periudhe 2011 – 2013 kane punuar ne ish ndermarrjen e sherbimeve publike njesi vartese e bashkise ku rezulton se ka perudha te sigurimeve shoqerore te papaguara nga ish ndermarrja.

Me ndryshimet e mesiperme ne buxhet do te realizojme dhe rikonstruksion e 450 m2 cati ne banesa kolektive dy kateshe te cilat nuk jane perfshire ne projektin e parqitur prane Ministrise Ekonomise per rikonstruksion e banesave te familjeve te pafavorizuara ku shpersojme te jene 40 familje.

Rikonstruksioni i cative do te behet ne banesat me nr ____ siperfaqe 200 m2 banesa nr siperfaqe 120 m2 _banesa nr ____ siperfaqe 130 m2 duke ndjekur te gjithe procedurat ligjore .

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Ligjore e Sherbimeve Organizative ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi.

Ju faleminderit. !

DREJTORIA ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

DREJTORI

Spiro KORA

Nepunes Zbatues

KRYETARI

Termet PEÇI

Nepunes Autorizues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 312/2 prot.

Tepelenë, më 21.02.2025

P/V E N D I M

Nr. , datë ____ .02 .2025

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN JANAR 2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore", neni 21 të ligjit nr.57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike", nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2025", Vendimit nr.597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr.868, datë, 29.12.2021; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr.3 datë 30.01.2025 "*Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor*", Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës ____ .02.2025

V E N D O S I:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 6% për muajin Janar **2025**, **14** familje me fond **65422**

lekë, bashkëlidhur sipas tabelës

+	EMER ATËSI MBIEMËR	NR ANTARËVE NË FAMILJE	SHUMA
	BASHKIA E QYTETIT TEPELENË		
1	ROVENA ASTRIT RACO	4	10692
2	BUJAR VESEL METO	1	2178
3	ANULA KANAN MAMA	2	3703
4	JETNOR ZYBER ÇUNAJ	1	2178
5	ELTON BARJAM ÇELA	2	3267

6	MELISA ADMIRIM DULAJ	2	5940
7	MARSELA MYZAFER ISUFI	2	3703
8	BRUNILDA MYZAFER KERI	4	10692
9	ALMIRA ÇETI HAZBIA	1	2178
10	BRUNILDA RIZA MAMA	2	3703
	SHUMA		48234
	NJESIA ADM. QËNDËR		
1	ANDON VANGJEL SHUMELI	3	5227
2	SHPETIM RAIF ALLKA	3	4792
	NJESIA ADM. KURVELESH		
1	MARJETA ZAÇE VESHI	1	2178
	NJESIA ADM LOPËS		
1	YLLI MYSLYM BRAHIMI	2	4991

		SHUMA TOTALE	65422

- Ngarkohet Drejtoria Ekonomike & Menaxhimit Financiar, Drejtoria Arsim Sportit Kujdesit Shoqëror (sektori I ndihmës ekonomike), Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

JURISTI
JULINDA KARTERI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
ARBEN GUMENI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

SEKTORI I NE & P.A.K

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN JANAR 2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.597, date 04.09.2019" Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike", nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2025", Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr 868 datë 29.12.2021; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr.3 datë 30.01.2025 "Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor" Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës _____. 02.2025

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	FAMILJE TE SKUALIFIKUARA	
		NR FAMILJEVE	FONDI FAKTIK LEKE
1	B. QYTETIT TEPELENË	9	37900
2	NJËSIA ADM. QËNDËR	9	45791
3	NJESIA ADM. KURVELESH	0	-----
4	NJESIA ADM. LOPËS	2	7385
	TOTALI		91076

Administratori Shoqëror: Armand Sala, Paola Demiri, Rovena Mullara, Festime Elezi

FAMILJET E MUAJIT JANAR QE NUK KAM MAR PIKET E PA MJAFUESHME NGA SISTEMI I PIKEZIMIT 2025

NJESIA ADMINISTRATIVE LOPS

7385

1	ADERIATIK ASLLAN BEQA	2	5	5	10	0	10	4	5	10	10	59		3682
2	ALEKSANDER MYRTO GJOKA	4	5	5	10	0	10	8	5	10	10	63		5860
3	BEHAR SAJET ISLAMI	4	5	5	10	0	10	8	5	10	10	63		5860
4	FATJON HEKURAN RREDHI	4	5	5	10	0	10	8	5	10	10	63		5860
5	FRUZELA HAXHI DERVISHI	2	5	5	10	0	10	4	5	10	10	59		3267
6	HISMET SADIK ZIA	5	5	5	10	0	10	10	5	10	10	65		6949
7	MEGLI PERPARIM HAXHIA	4	5	5	10	0	10	8	5	10	10	63		5860
8	REBANI BILBIL QYRDETI	2	5	5	10	0	10	4	5	10	10	59		3682
9	YLLI TASIM RUKA	3	5	5	10	0	10	6	5	10	10	61		4771
														45791

[illegible]

0

NEN 80C 10 PIKE

PIKEZIMI

ME FEMIJE NEN 18 VJEC	10 PIKE
ME FEMIJE MBI 18 VJEC	5 PIKE
IVE/DIVORCUAR/VECUAR	10 PIKE
PAK K/FAMILJAR	10 PIKE
PAK FAMILJAR	5 PIKE
cdo antar familje	2 pike

FAMILIE URBANE 5 PIKE

PA PASURI PALUAJTSHME 10 PIKE

ADMINISTRATOR SHOQEROR ARMAND SALA FESTIME ELEZI ROVENA MULLARA PAOLA DEMIRI

[Handwritten signatures]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

RELACION

**RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË PËR VITIN
2024**

Të nderuar!

- Këshilli i Bashkisë Tepelenë për vitin 2024 ka pasur një aktivitet intensiv në vendimarrje dhe në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin, rreth problematikave që janë shfaqur, duke u mbështetur te ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në legjislacionin sektorial për fusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore si dhe në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit bashkiak”.

Duke qënë se Këshilli, si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit, ka rol vendimarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, kemi ushtruar këto role me angazhim dhe përkushtim.

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përmbledhur të japim aktivitete kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer aktivitetet si më poshtë:

Gjatë vitit 2024 janë realizuar në total 14 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 2 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë. Gjatë vitit 2024 është mbledhur Kryesia e Këshillit Bashkiak e cila ka vendosur mbi rendin e ditës në secilën mbledhje.

Në total janë miratuar 78 vendime prej të cilave 22 vendime të konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, janë shqyrtuar 52 akte individual, 4 vendime të pakonfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Janë realizuar 12 mbledhje komisionesh.

Gjithashtu, kemi miratuar planin e punës të përbërë nga plani i vendimmarrjes, plani i konsultimeve publike dhe buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin me qëllim përmbushjen e të gjithë aktivitetit të parashikuar. Buxheti i Këshillit bashkiak është shpenzuar në masën 100%, në mbështetje të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara. Në kuadër të zbatimit të Planit të punës për vitin 2024, Këshilli bashkiak Tepelenë ka zhvilluar aktivitete që kanë konsistuar në:

- Një vizitë studimore në Zvicër (me bashkëfinancim). Kjo vizitë studimore është orgaqnizuar nga projekti “Bashki të Forta”, duke përzgjedhur 21 përfaqësues në rang kombëtar, me qëllim shkëmbimin e eksperiencaave me bashki dhe Këshilla bashkiak në Zvicër. Gjatë kësaj vizite studimore u perfaqesuam nga sekretari I keshillit ku ndanë eksperiencat, praktikat e mira si dhe u përpilua një plan pune me qëllim rritjen e cilësise dhe standardit të punës në vijim.

- Një vizitë studimore me Komunën dhe Kuvendin me pjesëmarrje të Kryetarit të bashkisë dhe përfaqësuesve të Këshillit bashkiak Tepelnë. Kjo vizitë pati për qëllim ndarjen e eksperiencave gjatë këtij mandati 4 vjeçar, praktikën e mira, respektimin e procedurave, zbatimin e Rregulloreve, trajtimin e ankes-kërkesave, rritjen e transparencës qytetarëve.
- Në mbështetje të Planit të punës, Aleanca e Grave Këshilltare, Komisioni I barazisë gjinore dhe Këshilli bashkiak organizuan një aktivitet sensibilizues dhe ndërgjegjësues në kuadër të "Tetorit Rozë" në bashkëpunim me Njësinë vendore të kujdesit shëndetsor, me pjesëmarrje të gjerë të grave dhe vajzave.
- Aleanca e Grave Këshilltare, Komisioni I barazisë gjinore ndërmorën një nismë me bazë gjinore (realizimi i një këndi lojrash për fëmijë pranë kopshtit "Murat Kociu"), nismë e cila u mbështet nga administratë dhe u parashikua në buxhetin e bashkisë për 2025.

Këshilli i Bashkisë Tepelenë ka punuar dhe bashkëpunuar ngushtësisht me projektin "Bashki të forta".

Ky bashkëpunim ka sjellë përmirësim dhe forcim të marrdhënieve midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre, këshilltarëve. Një vëmendje e vecantë i është kushtuar asistencës për rritjen e transparencës, nëpërmjet publikimit të materialeve të ndryshme në web dhe në media online, si rendi i ditës, njoftimi për mbledhjet e këshillit, publikimi i të gjithë vendimeve online, duke ofruar mundësinë për ti aksesuar në çdo kohë cdo qytetari. Shqyrtimi i të gjitha ankesave dhe kërkesave dhe zgjidhja sipas Rregullores si dhe përditësimi i regjistrit elektronik në web. Implementimi i rregulloreve, ka sjellë rritjen e standardeve dhe cilësisë së punës së këshillit në tërësi.

Këshilli bashkia ka shqyrtuar të gjithë projektvendimet dhe dokumentacionet shoqëruese në komisionet përkatëse cdo muaj.

Fal mbështetjes së projektit "Bashki të forta" nëpërmjet dhurimit të pajisjeve teknologjike, Këshilli i bashkisë Tepelenë ka transmetuar live mbledhjet e këshillit bashkiak, cka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të jap mendime dhe sygjerrime për çështje të ndryshme.

Njëkohësisht Këshilli bashkiak Tepelenë për vitin 2024 ka marr pjesë aktive në 3 trajnime në total, 2 trajnime me komisionet, me qëllim mbajtjen dhe plotësimin e raporteve për cdo mbledhje komisioni dhe shqyrtimi të projektvendimeve, si dhe trajnimi për drejtuesit e Këshillave bashkiak me qëllim fuqizimin e organeve vendimmarrëse përmes rritjes së kapaciteteve të këshilltarëve vendorë, organizuar nga Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV), Shkolla Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), Shoqata e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH) në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të Projektit "Bashki të Forta" (BtF2) i zbatuar nga Helvetas dhe i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2024 është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nëpërmjet komunikimit kryesisht prej publikimit dhe marrjes së mendimeve nëpërmjet rrjeteve sociale. Për këtë qëllim faqja e

Facebook-ut e Këshillit Bashkiak Tepelenë e cila u hap në vitin 2020, ka qënë aktive duke publikuar vazhdimisht aktivitetet të këshillit, konsultimet publike, rendin e ditës etj.

Konsultimet Publike – Viti 2024

Në zbatim të vendimit Nr. 82, datë 31.10.2023, mbi “Planin e Vendimmarrjes, Planin e Konsultimeve Publike dhe Buxhetin e Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2024”

si dhe bazuar në Rregulloren e Brendshme për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Tepelenë dhe Rregulloren e Konsultimit Publik (publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tepelenë), Këshilli Bashkiak Tepelenë ka organizuar dhe zhvilluar me sukses konsultimet publike për projekt-vendimet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi. Procesi i Konsultimeve Publike gjatë vitit 2024.

Në planin e konsultimeve publike janë parashikuar të organizohen konsultime publike për 5 tema;

- ☐ Plani i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027
- ☐ Paketa Fiskale
- ☐ Buxheti i Bashkisë për vitin 2025
- ☐ Ndryshim buxheti
- ☐ Miratim i planit të shërbimit publik
- ☐ Konsultim për blerje/dhenie me qera etj

Buxheti I parashikuar për konsultimet publike ka qënë në vlerën 159.000 lekë, me zëra si letër, bojë për printim dhe mjete kancelarie në funksion të materialeve që do të konsultohen.

Gjatë këtij viti, janë realizuar 5 konsultime publike për 4 projekt-aktesh kryesore:

- ☐ Plani i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027
- ☐ Paketa Fiskale
- ☐ Buxheti i Bashkisë për vitin 2025
- ☐ Planin e përmirësimit të shërbimit në arsimin parashkollor
- ☐ Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 15 datë 27.02.2020 të këshillit bashkiak Tepelenë “Për miratimin e rregullores së brendshme të këshillit të bashkisë Tepelenë”

Këshilli bashkiak Tepelenë, me një ndjeshmëri të lartë ndaj nevojave të komunitetit, dhe sidomos të komunitetit egjiptian ka organizuar një dëgjese të dedikuar me pjesëmarrje të këtij komunitetit. Bashkia do të mbështesë nga buxheti I bashkisë, një nismë apo iniciativë të propozuar nga ky komunitet me qëllim përmirësimin e aspekteve të caktuara të jetës së tyre.

Referuar planit, nuk janë realizuar dy konsultime të parashikuara, ndërkohë që janë realizuar dy

SHOQËRIMET
konsultim publik (Planin e përmirësimit të shërbimit në arsimin parashkollor, dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 15 datë 27.02.2020 të këshillit bashkiak Tepelenë “Për miratimin e rregullores së brendshme të këshillit të bashkise Tepelenë”) që nuk kanë qenë të parashikuar në Planin e Konsultimeve publike.

Në këtë mënyrë Plani I konsultimeve është realizuar 90%, dhe buxheti për konsultimet publike është shpenzuar 90%,

Gjatë këtyre proceseve janë mbajtur 5 takime publike me grupet e interesit.

Për çdo projekt-vendim janë hartuar dhe publikuar:

- ☐ Projekt-vendimet e propozuara,
- ☐ Njoftimet për konsultim publik,
- ☐ Kalendarët e takimeve (në përputhje me modelin e miratuar në rregulloret e Këshillit Bashkiak),
- ☐ Materialet shoqëruese.

Të gjitha këto janë përgatitur dhe publikuar duke respektuar afatet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Pjesëmarrja dhe Dokumentimi i Takimeve Publike

Takimet publike janë mbajtur dhe janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale të Këshillit Bashkiak. Në këto takime kanë marrë pjesë:

- ☐ Përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë,
- ☐ Qytetarë dhe banorë nga njësitë administrative,
- ☐ Përfaqësues të grupeve të interesit.

Gjatë takimeve publike janë respektuar të gjitha procedurat përkatëse, duke përfshirë:

- ☐ Mbajtjen e procesverbaleve,
- ☐ Listat e prezencës,
- ☐ Dokumentimin me foto.

Të dhëna mbi pjesëmarrjen

Në konsultimin publik, në Njësitë Administrative Lopës, për Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, Projekt buxhetit të vitit 2025, morën pjesë gjithsej 26 persona, nga të cilët 6 gra.

Në konsultimin publik, në Njësitë Administrative Kurvelesh, për Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, Projekt buxhetit të vitit 2025, morën pjesë gjithsej 27 persona, nga të cilët 7 gra.

Në konsultimin publik, në qytetin e Tepelenës dhe Njësia Administrative Qender, për Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, Projekt buxhetit të vitit 2025, morën pjesë gjithsej 149 persona, nga të cilët 65 gra.

Në konsultimin publik, në qytetin e Tepelenës, me komunitetin egjiptian dhe grupet vulnerabël për Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, Projekt buxhetit të vitit 2025, morën pjesë gjithsej 13 persona, nga të cilët 5 gra.

Rezultatet dhe Vendimet Përfundimtare

Pas përfundimit të konsultimeve publike dhe zbatimit të procedurave ligjore, Këshilli Bashkiak miratoi projekt-vendimet përkatëse, të cilat më pas morën konfirmimin e ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik I ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik I iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashkiës. Konkretisht janë depozituar në total 24 kërkesa, 1 ankesë, drejtuar Këshillit Bashkiak, 6 prej të cilave duke qënë se kanë qënë kompetencë e Këshillit është bërë e mundur marrja e vendimeve. Kërkesat e tjera janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet është kthyer përgjigje brenda afateve dhe procedurave të caktuara.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2024 u realizuan dhe u paraqitën në këshill 10 informacione, dhe raporte nga administrata parashikuar në planin e punës së këshillit.

Këshilli Bashkiak duhet të kërkoj nga administrata raporte sqaruese, cdo tre muaj mbi ecurinë dhe ekzekutimin e vendimeve të marra nga këshilli.

Këshilli bashkiak Tepelenë ka botuar buletin vjetor – Raport i aktivitetit të këshillit bashkiak për vitin 2024, në të cilën janë pasqyruar të gjitha aktivitetet e Këshillit bashkiak, sipas Planit të punës dhe më gjerë.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar bashkëpunëtorët që asistojnë në aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Tepelenë, projektin “Bashki të Forta”, ftojme të gjithë të bëhen pjesë për përmirësimin e punës së këshillit nëpërmjet mendimeve dhe sugjerimeve tuaja.

Punë të mbarë dhe faleminderit.

SEKRETARE KËSHILLIT

VALBONA ÇELA

